



Pranuar / Doretuar Priljeno/Prudato Received/Deliverty	17 - 11 - 2021	viti god year	
Organ /Njësia Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMBHCK	5496/2021		113



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.850/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.850/2021 të datës 05.10.2021 të parashtruar nga ankuesit dhe

të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati me adresë Rruga "Reçakut", 70 000 Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Inspektorati i Punës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorses së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.850/2021 e datës 05.10.2021 e parashtruar nga ankuesit dhe

A r s y e t i m

Ankuesit dhe të gjithë të punësuar në Inspektoratin e Punës, nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar avokatit me datë 01.10.2021 përmes Postës së Kosovës kanë parashtruar ankesën me numër të protokollit 4901/2021 të regjistruar me numër A.nr.850/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e shujtës ditore (2 euro në ditë) për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 duke llogaritur për secilin vit nga 229 ditë pune, pagesën e një page jubilarë dhe pagesën për pagën e trembëdhjetë në vlerë prej katër pagave, për secilin ankues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.10.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Inspektoratin e Punës. Me datë 14.10.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Inspektorati i Punës me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/12.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesve të datës 05.10.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën/Ankesën e datës 29.07.2021 të parashtruar në organin e punësimit; Fletë kthesa Postare e datës 11.08.2021; Akt emërimi i ankuesit Akt emërimi i ankuesit Akt emërimi i ankuesit si dhe përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesit dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesve, është e pa bazuar, sepse:

Ankuesit të punësuar në Inspektoratin e Punës, në pozita të nëpunësve civilë, përmes përfaqësuesit të tyre, me datë 11.08.2021 kanë parashtruar kërkesë në Inspektoratin e Punës, për kompensimin e shpenzimeve për ushqim gjatë punës, shpërblimit jubilar dhe pagën e trembëdhjetë për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018. Inspektorati i Punës sipas shkresave të lëndës nuk ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e ankuesve për kompensim material.

Ankuesit të pakënaqur me heshtjen për shqyrtim të kërkesës së datës 11.08.2021 të Inspektoratit të Punës ndaj kërkesës se tyre për kompensim material, në ankesën e datës 05.10.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes përfaqësuesit të tyre, pretendojnë që Inspektorati i Punës, nuk ka bërë kompensim e shpenzimeve për ushqim gjatë punës, shpërblimit jubilar dhe pagën e trembëdhjetë, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesve dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhe jo me shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017.

Bazuar në këtë konstatim, dhe në kuptim të nenin 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, Kolegji konstaton se kërkesa e ankuesve për realizimin e kompensimit të shpenzimeve për ushqim gjatë punës, shpërblimit jubilar dhe pagën e trembëdhjetë, për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018

është parashkruar, kështu që pretendimi ankimor i ankuesve mbi këtë bazë ligjore është i pa bazuar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nën 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.850/2021

Valentina Kaçandolli Bektashi


Procesmbajtëse



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat.
- Kryeinspektoriatit të Inspektoratit të Punës;
- Menaxheres së Personelit në Inspektoratin e Punës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.